



KËSHILLI KOMBËTAR I KONTABILITETIT

**RAPORTI I
VEPRIMTARISË
2020**



P Ë R M B A J T J A

I. Hyrje

1.1 Statusi

1.2 Përbërja dhe organizimi

1.3 Detyrat

II. Aktivitetet kryesore të vitit 2020

III. Informacion i detajuar mbi produktet e realizuara gjatë vitit 2020

3.1 Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

3.2 Standardet Kombëtare të Kontabilitetit

3.3 Hartimi i raporteve, formateve dhe udhëzuesve në zbatim të ligjit të kontabilitetit

3.4 Hartimi i akteve të tjera në zbatim të VKM 505, datë 17.07.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e KKK-së”

3.5 Detyra të realizuara në kuadër të Planit Kombëtar të Veprimit për Raportimin Financiar në Shqipëri

3.6 Raportime për MFE dhe MEPJ

3.7 Detyra të tjera të ngarkuara nga Këshilli

IV. Objektivat dhe plani i punës për vitin 2021

Shtojcë A - Realizimi i treguesve të buxhetit 2020

Shtojcë B - Pasqyrat financiare 2020

Shtojcë C - Parashikimi buxhetor për vitin 2021

SHKURTIME

AAJM	Aktive Afatgjata Jomateriale
AAM	Aktive Afatgjata Materiale
BE	Bashkimi European
BMP	Bordi i Mbikqyrjes Publike
BSNK	Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit
IAL	Institucionet e Arsimit të Lartë
IEKA	Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
IKM	Instituti i Kontabilistëve të Miratuar
KKK	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
NVM	Njësi ekonomike të Vogla dhe të Mesme
OJF	Organizata Jo Fitimprurëse
PKIE	Plani Kombëtar për Integrimin European
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
REPARIS	The Road to Europe: <i>Program of Accounting Reform and Institutional Strengthening</i>
SHKFSH	Shoqata e Kontabilistëve dhe Financierëve të Shqipërisë
SHKM	Shoqata e Kontabilistëve të Miratuar
SKK	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
SNK	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit
SNRF	Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

I. Hyrje

1.1 Statusi - Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit funksionon me ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. KKK është organizëm profesional publik i pavarur dhe gëzon personalitet juridik. Veprimtaria e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit financohet nga buxheti i shtetit. KKK ka të drejtë të përdorë edhe të ardhurat që realizon nga punët që kryen. Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit raporton me shkrim pranë ministrit përgjegjës për financat, brenda 3-mujorit të parë të vitit pasardhës, në lidhje me veprimtarinë vjetore të tij. Pjesë të këtij raporti ku trajtohen me hollësi edhe problemet e konstatuara gjatë monitorimeve në lidhje me përgatitjen e pasqyrave financiare, si dhe zgjidhjet e sugjeruara, i dërgohet për informacion dhe Bordit të Mbikëqyrjes Publike brenda po këtij afati.

1.2 Përbërja dhe organizimi - Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit përbëhet nga 7 anëtarë.



Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit mandatohen me urdhër të ministrit përgjegjës për financat dhe kanë mandat 4-vjeçar. Ata mund të rimandatohen vetëm një herë me miratimin e ministrit përgjegjës për financat.

Kandidatët për anëtarë të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit duhet të jenë persona me edukim në fushën e kontabilitetit dhe/ose financës, si dhe ekspertë në teorinë dhe metodologjinë e kontabilitetit ose praktikues në fushën e kontabilitetit. Kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të KKK-së përcaktohen në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr 505, datë 17.07.2019 “Për miratimin e rregullores së funksionimit dhe organizimit të KKK-së”. Kryetari dhe nënkryetari i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit zgjidhen nga anëtarët e këshillit, sipas procedurave të përcaktuara në rregullore. Për realizimin e detyrave, anëtarët angazhohen me kohë jo të plotë pune.

Me Urdhër të Ministrit përgjegjës të Financave, nr 397/1, datë 26.11.2019 “Për emërimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”, anëtarët e mandatuar të KKK-së janë:

- | | |
|-------------------------|--------------------------------------|
| 1. Zj. Greta Angjeli | Kryetar |
| 2. Zj. Ingrid Shuli | Nënkryetar |
| 3. Zj. Vjollca Karapici | Anëtar (ndarë nga jeta në mars 2021) |
| 4. Zj. Eleonora Olli | Anëtar |

- | | |
|--------------------|--------|
| 5. Zj. Edlira Luçi | Anëtar |
| 6. Z. Fatos Beqja | Anëtar |
| 7. Zj. Alma Beja | Anëtar |

Gjatë vitit 2020 kanë dhënë dorëheqjen nga angazhimi, për arsye të motivuara, dy anëtarë të Këshillit dhe puna ka vijuar me kontributin e anëtarëve të tjerë. Me Urdhër të Ministrit përgjegjës të Financave, nr 302/1, datë 15.12.2020 “Për emërimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”, është emëruar anëtari i ri Znj. Loreta PEÇI. Këshilli në zbatim të VKM 505, datë 17.07.2019 “Për miratimin e Rregullores së funksionimit dhe organizimit të KKK-së” do të iniciojë procedurat për plotësimin e dy vendeve vakant.

1.3 Detyrat - Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, në zbatim të ligjit të kontabilitetit ka për detyrë:

a) të hartojë standardet kontabël kombëtare, në përputhje me kërkesat e ligjit 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe në koherencë me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar;



b) të përpunojë një sistem kontabël, ku, përveç standardeve kombëtare të kontabilitetit, të përcaktojë rregullat për mbajtjen e kontabilitetit, si dhe formatet për pasqyrat financiare;

c) të evidentojë nevojat dhe të propozojë zgjidhjet për përmirësimin e metodave kontabël për mbajtjen e kontabilitetit dhe për kualifikimet;

d) të interpretojë dhe të përgjithësojë problemet që dalin nga praktika dhe standardet kontabël, të cilat i paraqet në formën e udhëzimeve kontabël;

e) të shqyrtojë dhe të japë mendime për të gjitha projektligjet dhe projektaktet nënligjore, rregulluese, të cilat përmbajnë dispozita për kontabilitetin, për përgatitjen e llogarive, që lidhen me njësitë ekonomike, subjekte të këtij ligji, si dhe me profesionet me bazë kontabilitetin;

f) të vendosë marrëdhënie me organizata profesionale vendase e të huaja dhe të marrë pjesë në veprimtaritë kombëtare dhe ndërkombëtare për kontabilitetin;

- g) të publikojë në faqen zyrtare të institucionit Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, të detyrueshme për zbatim. Gjithashtu, ka të drejtën të publikojë edhe materiale të tjera, jo të detyrueshme për zbatim, me karakter dhe qëllim informues, në funksion të mbajtjes së kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare;
- h) të botojë Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe materiale të tjera për zbatim në lidhje me këto standarde;
- i) të monitorojë zbatimin e standardeve të kontabilitetit dhe raportimit financiar;
- j) të organizojë tryeza të rrumbullakëta, seminare, konferenca dhe të tjera të ngjashme me to, me qëllim rritjen e transparencës përmes përfshirjes së palëve të interesit në procesin e përmirësimit të raportimit financiar, informimin e palëve të interesit për zhvillimet në këtë fushë, si dhe nxitjen e zbatimit korrekt të SKK-ve/SNRF-ve nga njësitë ekonomike.

Në mbledhjen e parë të vitit, Këshilli, si rregull, miraton programin vjetor të punës për vitin në vazhdim. Programi i hartuar synon përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga akte ligjore dhe nënligjore në fuqi, të cilat rregullojnë organizimin dhe funksionimin e KKK-së. Gjithashtu programi është në përputhje me misionin publik të KKK-së si standard hartues në fushën e raportimit financiar.

Detyrat e parashikuara në planin e punës, sipas muajve përkatës, bëhen pjesë e rendit të ditës së mbledhjeve të parashikuara në kalendarin vjetor.

II. Aktivitetet kryesore të vitit 2020

Detyrat për vitin 2020, miratuar nga KKK-ja në mbledhjen e parë të vitit 2020 si dhe statusi i realizimit të tyre, paraqiten si më poshtë:

Nr	Muaji	DETYRAT	Miratimi
1	Shkurt	Raporti i performancës së OJF-ve;	Vendimi KKK 4/1, datë 17.06.2020
		Programi i punës për vitin 2020;	Miratuar
		Raporti i Veprimtarisë 2019;	Minutat e takimit / Mbledhja e datës 27/03/2020
		Raport mbi pasqyrat financiare të monitoruara në periudhën Janar – Shkurt 2020;	Realizuar
2	Mars	Përgatitur për publikim varianti i konsoliduar i SNRF-ve, të publikuara deri në vitin 2018;	Minutat e takimit / Mbledhja e datës 27/03/2020
		Përgatitur Manuali i Procedurave për Monitorimin e Zbatimit të SNRF-ve dhe SKK-ve;	Minutat e takimit / Mbledhja e datës 24/06/2020
		Përgatitja për miratim e Marrëveshjes së Bashkëpunimit të KKK-së me Qendrën Kombëtare të Biznesit;	Realizuar
		Përgatitja për miratim e Marrëveshjes së Bashkëpunimit të KKK-së me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve;	Realizuar
		Ngritja e Komisioneve të Posaçëm të Përhershëm në KKK;	Vendimi KKK 5, datë 26.06.2020
3	Mars	Përgatitur Udhëzuesi shtesë “Për plotësimin e pasqyrës së të ardhurave gjithëpërfshirëse” (i publikueshëm në faqen zyrtare të KKK-së);	Minutat e takimit / Mbledhja e datës 27/03/2020
		Përgatitur kërkesat e rishikuara ndaj njësive ekonomike të vogla për shënime shpjeguese në përputhje me sa parashikohet në Dir 34/2013/EU; SKK 4, SKK 5, SKK 6;	Minutat e takimit / Mbledhja e datës 28/05/2020
		Përgatitur “Rregullorja e brendshme e strukturës mbështetëse të KKK-së” në zbatim të VKM 505, datë 17.07.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e KKK-së”;	Minutat e takimit / Mbledhja e datës 24/06/2020
4	Prill	Përmbyllur analiza e tabelës së përputhshmërisë (<i>mes kuadrit shqiptar të raportimit financiar dhe Dir 34/2013/EU</i>) me synim identifikimin e hapave pasues drejt transpozimit të plotë;	Realizuar
		Raport mbi pasqyrat financiare të monitoruara në periudhën Mars – Prill 2020;	Realizuar
5	Maj	Përgatitur Draft “Kodi i Etikës së KKK-së”, në zbatim të VKM 505, datë 17.07.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e KKK-së”;	Minutat e takimit / Mbledhja e datës 24/06/2020
		Përgatitur Udhëzuesi për hartimin e Raportit Jofinanciar (Ligji 25/2018, neni 18);	Minutat e takimit / Mbledhja e datës 24/06/2020
6	Qershor	Raport mbi pasqyrat financiare të monitoruara në periudhën Maj – Qershor 2020;	Realizuar

		Përgatitur kërkesat e rishikuara ndaj njësisve ekonomike të vogla për shënime shpjeguese në përputhje me sa parashikohet në Dir 34/2013/EU; SKK 7, SKK 8, SKK 9, SKK 10, SKK 11;	Minutat e takimit / Mbledhja e datës 24/06/2020
		Përgatitur për publikim varianti i konsoliduar i SNRF-ve, të publikuara deri në vitin 2019;	Minutat e takimit / Mbledhja e datës 24/06/2020
7	Korrik	Rishikuar udhëzuesi për zbatim i SKK 4 <i>Inventarët</i> ;	Minutat e takimit / Mbledhja e datës 15/07/2020
		Rishikuar Kodi i Etikës së KKK-së;	Në proces
8	Shtator	Rishikuar udhëzuesi për zbatim i SKK 5 <i>Aktivitet Afatgjatë Materiale dhe Aktivitet Afatgjatë JoMateriale</i> ;	Minutat e takimit / Mbledhja e datës 30/09/2020
		Përgatitur Rekomandimi për përgatitjen e raportit të drejtimit të brendshëm (transpozim i Rekomandimit të KE të 9 Prill 2014, 2014/208/EU) në zbatim të nenit 19 të ligjit të kontabilitetit;	Minutat e takimit / Mbledhja e datës 04/12/2020
9	Shtator	Rishikuar udhëzuesi për zbatim i SKK 7 <i>Qiratë</i> ;	Minutat e takimit / Mbledhja e datës 04/12/2020
		Përgatitur Pyetësori me IAL-të “Zhvillimet më të fundit në fushën e raportimit financiar dhe rishikimi i kurikulave universitare në përputhje me to”;	Minutat e takimit / Mbledhja e datës 04/12/2020
		Takim online me anëtarë të PAO-ve mbi problematikat në lidhje me zbatimin e kërkesave të reja ligjore për raportet jofinanciare; Vlerësimi i nevojës për udhëzime shtesë mbi hartimin e raporteve të reja jo-financiare pas feedback-ut të marrë nga tryeza e rumbullakët;	I perealizuar
		Raport mbi pasqyrat financiare të monitoruara në periudhën Korrik – Shtator 2020;	Realizuar
10	Tetor	Rishikuar udhëzuesi për zbatim i SKK 9 <i>Kombinimi i Bizneseve</i> ;	Minutat e takimit / Mbledhja e datës 11/12/2020
		Përgatitur materiali shpjegues mbi përmbajtjen dhe strukturën e një dokumenti orientues për njësitë ekonomike në fazën e përgatitjes së pasqyrave financiare (check list e zërave të paraqitur në pasqyra dhe paragrafëve përkatës në SKK) ;	Minutat e takimit / Mbledhja e datës 11/12/2020
11	Nëntor	Rishikuar udhëzuesi për zbatim i SKK 13 <i>Aktivitet biologjike dhe marrëveshjet koncesionare</i> ;	Minutat e takimit / Mbledhja e datës 18/12/2020
		Përgatitur Draft check list e zërave të paraqitur në pasqyra dhe paragrafëve përkatës në SKK;	Minutat e takimit / Mbledhja e datës 11/12/2020
		Takime studentore / Tryeza të rumbullakëta;	I perealizuar
		Përgatitur kërkesat e rishikuara ndaj njësisve ekonomike të vogla për shënime shpjeguese në përputhje me sa parashikohet në Dir 34/2013/EU SKK 12, SKK 13, SKK 14;	Minutat e takimit / Mbledhja e datës 11/12/2020
12	Dhjetor	Përgatitur kërkesat e rishikuara ndaj njësisve ekonomike të vogla për shënime shpjeguese në përputhje me sa parashikohet në Dir 34/2013/EU, SKK 3 <i>Instrumentet Financiare</i> ;	Minutat e takimit / Mbledhja e datës 18/12/2020
		Përgatitur materiali paraprak për identifikimin e ndërhyrjeve në SKK-të e përmirësuara për përditësimin e referencave ligjore;	Minutat e takimit / Mbledhja e datës 18/12/2020
		Raport mbi pasqyrat financiare të monitoruara në periudhën Tetor – Dhjetor 2020;	Realizuar
		Diskutimi i Projekt Idesë për programin e punës 2021.	Realizuar

Detyra të tjera të realizuara gjatë kësaj periudhe nga KKK-ja janë:

1. Përkthyer ndryshimet e SNRF-ve, dërguar tek Ministri përgjegjës i Financave për shpallje;
2. Përfunduar përgatitja e variantit të konsoliduar 2020 të SNRF-ve të përkthyer (SNRF-ve të publikuara deri në dhjetor 2019) dhe publikuar në faqen e internetit të Këshillit <http://kkk.gov.al/faqe.php?id=1&l2=135&gj=sh>;
3. Raportime periodike për Ministrinë e Evropës dhe Punëve të Jashtme (mbi informacionet e kërkuara nga Shërbimet e Komisionit Europian për Kapitullin 6 *Ligji Tregtar*);
4. Raportime periodike për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në lidhje me realizimin e detyrave institucionale dhe përfshirjen e tyre në kontributin për progresin e Shqipërisë;
5. Përgatitja e informacionit për vërtetimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe raportimi mbi cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë;
6. Komunikimi dhe kthim përgjigjet për njësitë ekonomike në lidhje me interpretime të ndryshme për standarde kombëtare të kontabilitetit;
7. Përditësimi i faqes së internetit të KKK-së;
8. Përgatitur pasqyrat financiare 2020;

III. Informacion i detajuar mbi produktet e realizuara



3.1 Standardet ndërkombëtare të raportimit financiar

a) Përkthimi i SNRF-ve

Gjatë vitit 2020, janë përkthyer, rishikuar, miratuar në KKK dhe shpallur për zbatim, nga Ministri përgjegjës për financat, materialet e publikuara nga BSNK gjatë vitit 2019, si më poshtë:

Titulli	Data Efektive	Urdhri i Ministrit përgjegjës për Financat
Ndryshime në SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7 <i>Reforma e Normës së Interesit që Shërben si Standard Krahasues (Benchmark)</i>	Pas 1 Janar 2020	Nr. 88, datë 03.04.2020

Gjithashtu janë përkthyer, rishikuar, miratuar në KKK dhe shpallur për zbatim materialet e publikuara nga BSNK gjatë vitit 2020, paraqitur në tabelën si më poshtë.

Titulli	Data Efektive	Urdhri i Ministrit përgjegjës për Financat
Ndryshime në SNRF 16 <i>Koncesionet e Qirasë të Lidhura me Covid-19</i>	1 qershor 2020	Nr 180, datë 22.07.2020
Ndryshime të SNRF 9 <i>Instrumentet financiare</i>	1 janar 2021	Nr 289, datë 02.12.2020
Ndryshime në SNK 39 <i>Instrumentet financiarë "Njohja dhe matja"</i>	1 janar 2021	Nr 289, datë 02.12.2020
Ndryshime në SNRF 16 <i>"Qiratë"</i>	1 janar 2021	Nr 289, datë 02.12.2020
Ndryshime të SNRF 7 <i>Instrumentet financiare "Dhënia e informacioneve shpjeguese"</i>	1 janar 2021	Nr 289, datë 02.12.2020
Ndryshime të SNRF4 <i>Kontratat e sigurimit</i>	1 janar 2021	Nr 289, datë 02.12.2020

Ndryshime në SNRF 3 <i>Kombinimet e biznesit</i>	1 janar 2022	Nr 180, datë 22.07.2020
Ndryshimet në SNRF1 <i>Adoptimi për Herë të Parë i SNRF-ve</i>	1 janar 2022	Nr 180, datë 22.07.2020
Ndryshimet në SNRF9 <i>Instrumentet financiare</i>	1 janar 2022	Nr 180, datë 22.07.2020
Ndryshimet në SNK 41 <i>Bujqësia</i>	1 janar 2022	Nr 180, datë 22.07.2020
Ndryshime në SNK 37 <i>Provizionet, Detyrimet dhe Aktivitet e Kushtëzuara</i>	1 janar 2022	Nr 180, datë 22.07.2020
Ndryshime në SNK 16 <i>Aktivitet Afatgjata Materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje)</i>	1 janar 2022	Nr 180, datë 22.07.2020
Ndryshime në SNK 1 <i>Klasifikimi i Detyrimeve si Afatshkurtra ose Afatgjata</i>	1 janar 2022	Nr 167, datë 03.07.2020
Ndryshime në SNK 1 (përditësuar) <i>Paraqitja e Pasqyrave Financiare</i>	1 janar 2023	Nr 253, datë 23.10.2020
Ndryshime të SNRF 17 <i>Kontratat e sigurimit</i>	1 janar 2023	Nr 261, datë 27.10.2020
Ndryshime të SNRF 4 <i>Kontratat e sigurimit/Instrumentet financiare</i>	1 janar 2023	Nr 261, datë 27.10.2020

b) Përgatitja e variantit të konsoliduar të SNRF-ve

Në 4 mars 2020, BSNK në përputhje me termat e kontratës, dërgoi materialin *Red Book 2020*. Këshilli, në përputhje me variantin në gjuhën angleze përgatiti variantin e konsoliduar 2020 të SNRF-ve në gjuhën shqipe, përmes programit TRADOS.

Si procedurë, në variantin e konsoliduar të vitit 2020 përfshihen SNRF-të e publikuara nga BSNK deri në dhjetor të vitit 2019. Varianti i konsoliduar 2020 u publikua në faqen zyrtare të KKK-së në qershor 2020 (<http://kkk.gov.al/faqe.php?id=1&l2=135&gj=sh>).



Standardet Kombëtare të Kontabilitetit

a) Plotësimi me udhëzues për zbatim i SKK 2”Përgatitja e pasqyrave financiare”

Në raportin e veprimtarisë për vitin 2019, u konstatua si një problematikë e hasur në disa njësi ekonomike, ajo e mos përgatitjes së pasqyrës së të ardhurave gjithëpërfshirëse apo e përgatitjes gabim të kësaj pasqyre. Për këtë arsye, Këshilli caktoi si detyrë në planin e punës 2020, hartimin

e një udhëzuesi plotësues për SKK 2 *Paraqitja e pasqyrave financiare*, udhëzues i orientuar tërësisht në përgatitjen e pasqyrës së të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

Udhëzuesi i hartuar, përveç pjesës përshkruese, ka edhe ushtrime të cilat ilustrojnë rast pas rasti zërat e kësaj pasqyre (cilat të ardhura dhe shpenzime përfshihet në secilin prej tyre).

Udhëzuesi u përgatit brenda muajit mars dhe në mbledhjen e datës 27 mars 2020 u miratua për publikim.¹

b) Rishikimi i shënimeve shpjeguese

Në tabelën e përputhshmërisë përgatitur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në kuadër të detyrave të Qeverisë për integrimin në BE, është lënë rekomandimi për reduktimin e shënimeve shpjeguese që përgatiten nga njësitë ekonomike të vogla. Ky shënim reflektohet edhe në pyetjet e Shërbimeve të Komisionit Europian të cilat vijnë për institucionet që kanë detyrimin për të raportuar. KKK raporton për çështjet e Kapitullit 6 *Ligji tregtar – Kontabiliteti dhe Auditimi*.

Rekomandimi i Shërbimeve të Komisionit Europian është që shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare të njërive ekonomike të mos tejkalojnë ato shënime që parashikohen në nenin 16 *Përmbajtja e shënimeve shpjeguese për të gjitha njësitë ekonomike*² dhe 17 *Shënime shpjeguese shtesë për njësitë e mesme, të mëdha dhe ato me interes publik*³ të Direktivës 34/2013/EU, ndryshuar me Direktivën 95/2014/EU.

Në adresimin e kësaj kërkesë, KKK përgatiti tabelën e përputhshmërisë mes (a) kërkesave për shënime shpjeguese parashikuar në SKK-të 1-14 dhe (b) kërkesave të limituara për shënime shpjeguese parashikuar në nenet 16 dhe 17 të Dir 34/2013/EU. Nga tabela vërehet se ka një numër të konsiderueshëm kërkesash (paragrafësh) të shënimeve shpjeguese të SKK-ve që nuk parashikohen në Direktivë. Për këtë çështje Këshilli pas diskutimeve ka dhënë propozimin për rastet kur vlerëson të hiqet/të rishikohet/të mos hiqet një shënim i caktuar.

¹ <http://kkk.gov.al/foto/uploads/File/Shembuj%20per%20ndertimin%20e%20pasqyres%20se%20te%20ardhurave%20te%20tjera%20gjitheperfs hirese.pdf>

² **Article 16 (3) Content of the notes to the financial statements relating to all undertakings**

Member States SHALL NOT REQUIRE disclosure for small undertakings beyond what is required or permitted by this Article.

³ **Article 16 (2) Content of the notes to the financial statements relating to all undertakings**

Member States may require mutatis mutandis that small undertakings are to disclose information as required in points (a), (m), (p), (q) and (r) of Article 17(1).

Në mbledhjen e muajit maj u diskutuan shënime shpjeguese të SKK 4 *Inventarët*, SKK 5 *Aktivitet afatgjata materiale dhe jomateriale* dhe SKK 6 *Provizionet, detyrimet dhe aktivitet kushtëzuara*. Në mbledhjen e muajit qershor u diskutuan dhe miratuan ndryshimet e shënimeve shpjeguese për SKK 7 *Qiratë*, SKK 8 *Të ardhurat*, SKK 9 *Kombinimi i bizneseve*, SKK 10 *Grantet dhe forma të tjera të ndihmës* dhe SKK 11 *Tatimi mbi fitimin*.

Në mbledhjen e rradhës, datë 11 dhjetor u diskutuan dhe miratuan ndryshimet e shënimeve shpjeguese të SKK 12 *Efektet e kurseve të këmbimit*, SKK 13 *Aktivitet biologjike dhe marrëveshjet koncesionare* dhe SKK 14 *Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta*.

Ndërsa në mbledhjen e datës 18 dhjetor u diskutuan dhe miratuan ndryshimet e shënimeve shpjeguese të SKK 3 *Instrumentet financiare*. Standardet e tjera, përkatësisht SKK 1 *Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare* dhe SKK 2 *Paraqitja e pasqyrave financiare* janë parashikuar për t'u përfunduar gjatë vitit 2021 sipas kalendarit të miratuar në programin e ri të punës për vitin 2021.

Në përfundim të rishikimit të shënimeve shpjeguese të të gjitha SKK-ve, KKK do t'i miratojë për t'i dërguar për shpallje pranë Ministrit përgjegjës për financat. Kjo detyrë është parashikuar të përfundojë brenda 6 mujorit të parë të vitit 2021.

c) Rishikimi i udhëzuesve të SKK-ve

Në programin e punës 2020 është parashikuar të përmirësohen disa nga udhëzuesit e SKK-ve. Konkretisht u punua për udhëzuesin e SKK 4 *Inventarët*, SKK 5 *Aktivitet afatgjata materiale dhe jomateriale*, SKK 7 *Qiratë*, SKK 9 *Kombinimi i bizneseve* dhe SKK 13 *Aktivitet biologjike dhe marrëveshjet koncesionare*. Metodologjia e miratuar për përmirësimet e udhëzuesve të SKK-ve konsiston në dy drejtime: (1) përmirësimi i materialit ekzistues duke korigjuar të gjitha problematikat e konstatuara në vitet e zbatimit të këtyre udhëzuesve dhe (2) pasurimi i udhëzuesve me shpjegime, ilustrime dhe ushtrime të reja.

Pas diskutimeve në Këshill, faza përgatitore me Udhëzuesit konsiderohet e përfunduar. Megjithatë, në përfundim të procesit të përmirësimit të të gjithë Udhëzuesve për SKK 1 deri SKK 15, ato do të publikohen në faqen zyrtare të internetit të KKK-së për komente dhe diskutime me palë të tjera të interesit. Publikimi për komente është parashikuar në tremujorin e tretë të vitit 2021.



3.2 *Hartimi i raporteve, formateve dhe udhëzuesve*

Në mbështetje të Ligjit 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Këshilli ka punuar për hartimin e disa raporteve dhe udhëzuesve për zbatimin korrekt të këtij ligji.

- a) Raporti vjetor i veprimtarisë së KKK-së për vitin 2019;
- b) Raporti i performancës së OJF-ve;
- c) Metodologjia e monitorimit të zbatimit të standardeve të kontabilitetit dhe raportimit financiar;
- d) Udhëzuesi për raportimin jofinanciar;
- e) Rekomandimi për cilësinë e raportit të drejtimit të brendshëm;
- f) Lista e kontrollit të zërave të pasqyrës së pozicionit financiar me paragrafët përkatës të SKK-ve që parashikojnë njohjen, matjen dhe vlerësimin e mëpasshëm të tyre;

a) Raporti i veprimtarisë për vitin 2019. Në ligjin e kontabilitetit, neni 27 (1) dhe 27 (2) parashikohet që Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit raporton me shkrim pranë Ministrin përgjegjës për financat, brenda 3-mujorit të parë të vitit pasardhës, në lidhje me veprimtarinë vjetore të tij. Raporti, pjesa ku trajtohen me hollësi problemet e konstatuara gjatë monitorimeve në lidhje me përgatitjen e pasqyrave financiare, si dhe zgjidhjet e sugjeruara, i dërgohet për informacion Bordit të Mbikëqyrjes Publike, brenda afatit të pikës 1, të këtij neni.

Raporti i veprimtarisë 2019, u hartua, u diskutua dhe u miratua për t’u dërguar, brenda të gjitha afateve, tek ministri përgjegjës për financat dhe Bordi i Mbikëqyrjes Publike. Gjithashtu raporti i veprimtarisë u publikua në faqen e internetit të KKK-së, <http://www.kkk.gov.al/faqe.php?id=9&l2=157&gj=sh>.

b) Raporti i performancës së OJF-ve. Ligji nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, në nenin 22 (3), ngarkon KKK-në të hartojë formatin dhe udhëzuesin në zbatim të tij të Raportit të Performancës së OJF-ve. Ky raport, i detyrueshëm për t’u përgatitur nga OJF-të që tejkalojnë vlerën 30 milion lekë të aktivitetit ose të të ardhurave, duhet publikuar në faqen e internetit të OJF-së bashkë me pasqyrat e tjera financiare.

Në konkluzion të diskutimeve të vijueshme në mbledhjet e KKK-së, lidhur me kundërshtinë e disa OJF-ve për hartimin e detyrueshëm të këtij raporti, u miratua varianti i thjeshtuar i formatit dhe udhëzuesit në zbatim të tij. Në mbledhjen e muajit maj u mor vendimi për publikimin e tij në faqen e internetit të KKK-së <http://www.kkk.gov.al/faqe.php?id=4&l2=164&gj=sh>.

Për raportimin financiar të OJF-ve, Këshilli ka paraqitur me shkrim tek Ministri përgjegjës për financat propozimin për të ndërmarrë iniciativën e propozimit për ndryshime ligjore me synimin e lehtësimit të raportimit të tyre si dhe rishikimin e disa kërkesave brenda të njëjtit ligj të cilat krijojnë përplasje mes tyre dhe konfuzion për OJF-të, zbatuese të këtyre kërkesave.

KKK në shkresën për të iniciuar disa ndryshime ligjore, ka propozuar që të krijohet depozitari i pasqyrave financiare të OJF-ve duke mundësuar kështu transparencën e plotë ndaj publikut, nga njëra anë, por gjithashtu edhe monitorimin e OJF-ve në lidhje me zbatimin e kërkesës ligjore të përgatitjes dhe publikimit të informacionit financiar, sipas kërkesave të parashikuara në ligjin për kontabilitetin

c) Metodologjia e monitorimit të zbatimit të standardeve të kontabilitetit dhe raportimit financiar. Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, KKK kërkoi nga Grupi i Bankës Botërore (Programi REPARIS) që në kuadër të projektit CFREP (faza II) të mbështetej me ekspertizë në përgatitjen e metodologjisë për monitorimin e zbatimit të standardeve të kontabilitetit dhe raportimit financiar. Me ndihmën e konsulentit të WB u përgatit dokumenti “Work paper on the monitoring methodology”. Ky material ishte parashikuar të dorëzohet si një ‘Concept paper’ në këtë fazë të projektit të WB për t’u zgjeruar dhe detajuar më pas në një dokument të plotë pune, në fazën e tretë të projektit CFREP. Ky fakt evidentohet edhe në dokumentin ‘*Strategy and Action Plan to Enhance Corporate Financial Reporting in Albania 2020 – 2023*’.

Në takimet e zhvilluara në periudhën 2018-2019 me përfaqësues të World Bank Group, Programi REPARIS, KKK-ja ka kërkuar që në kuadër të fazës së tretë të CFREP të financohet një projekt pilot për KKK që parashikon krijimin e një bërthame departamenti kërkim-monitorim (research and monitoring). Funkzioni i kësaj bërthame parashikohej të ishte kryesisht mbledhja e të dhënave nga njësitë ekonomike lidhur me problematikat në zbatimin e SKK-ve, përpunimin statistikor të tyre me qëllim arritjen e përfundimeve të vlefshme për vendim-marrjen e KKK-së në përmirësimin e produkteve të veta.

Funksion i kësaj bërthame do të ishte dhe testimi i procedurave të qëndrueshme të monitorimit mbi baza risku të pasqyrave financiare me synim krijimin e një database të mjaftueshme për të vlerësuar cilësinë e zbatimit të SKK-ve por dhe sfidat e përmirësimit të zbatueshmërisë së tyre. Ndër rezultatet e pritshme të monitorimit të pasqyrave do të ishin:

- Përmirësimi i produkteve kontabël (standardeve dhe udhëzuesve në zbatim të tyre);
- Evidentimi i zonave të pambuluara (sektorë apo forma të reja të biznesit që nuk mbulohen nga SKK-të ekzistuese);
- Nevoja për rishikimin e kurikulave të IAL dhe organizmave profesional me synim rritjen e cilësisë së profesionistëve të rinj dhe atyre të praktikës në fushën e kontabilitetit dhe raportimit financiar;

Materiali i përgatitur nga stafi i WB Group, Programi REPARIS, i'u vu në dispozicion anëtarëve të KKK-së që në fillim të këtij viti. Gjithashtu, me porosi të tyre i'u shpërnda për mendim edhe palëve të interesuara. Diskutimet për përmirësimin e këtij dokumenti pune janë një proces i vazhdueshëm. Për procedurë ky dokument miratohet në KKK dhe bëhet i zbatueshëm nga Inspektori i monitorimit, pjesë e strukturës administrative të KKK-së.

Duke vlerësuar maksimalisht rëndësinë e procesit të monitorimit të zbatimit të standardeve të raportimit financiar, Këshilli vendosi t'i propozojë Ministrit përgjegjës për financat mbështetjen e mëtejshme me fonde me qëllim që të ngrihet një grup ekspertësh (projekt pilot) dhe të fillojë puna për monitorimin e pasqyrave. Eksperienca dhe modeli i krijuar nga ky grup ekspertësh do të shërbejë për të testuar metodologjinë e hartuar si dhe aftësimin e stafit të KKK-së për ta vijuar më tej këtë detyrë me cilësinë e kërkuar.

➤ *Gjetjet nga monitorimi i pasqyrave financiare*

Në zbatim të kërkesës së ligjit nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” janë monitoruar pasqyrat financiare të 45 njësive ekonomike. Pasqyrat financiare janë siguruar nga faqja zyrtare e QKB-së dhe paraqesin informacionin financiar për vitet 2017-2018. Përzgjedhja e njësive ekonomike është bërë në mënyrë të rastësishme.

Nga njësitë e marra në shqyrtim:

- **5** njësi ekonomike zbatojnë **SNRF**
- **39** njësi ekonomike zbatojnë **SKK 1-14**
- **1** njësi ekonomike zbaton **SKK 15**

Gjetjet gjatë monitorimit të pasqyrave financiare:

1. **10 (dhjetë)** shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe **16 (gjashtëmbëdhjetë)** shoqëri **aksionare** nuk kanë dhënë shënime shpjeguese përshkruese sipas SKK-ve por vetëm informacion të përsëritur numerik, marrë nga pasqyrat financiare.
2. **4 (katër)** shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe **2 (dy)** shoqëri **aksionare** nuk e kanë të bashkëlidhur pasqyrën e shënimeve shpjeguese.
3. **11 (njëmbëdhjetë)** shoqëri **aksionare** dhe **10 (dhjetë)** shoqëri me përgjegjësi të kufizuar kanë mosrakordim midis shifrave të shpjeguara tek shënimet dhe shifrave të raportuara tek pasqyrat financiare.
4. **5 (pesë)** njësi ekonomike **shoqëri aksionare** nuk e kanë të publikuar pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.
5. Pasqyrat financiare të **3 (tre)** njësive ekonomike sh.a janë hartuar sipas **SNRF-ve** ndërsa në shënimet shpjeguese subjektet shprehen se shënimet janë hartuar sipas **SKK-ve**.

d) Udhëzuesi për përgatitjen e raportit jo-financiar. Në nenin 18 të ligjit të kontabilitetit parashikohet që njësitë ekonomike të mëdha dhe me interes publik, të cilat tejkalojnë një numër mesatar mbi 500 të punësuar gjatë periudhës raportuese, duhet të hartojnë një raport jofinanciar si pjesë përbërëse e raportit të ecurisë së veprimtarisë. Ky nen ka harmonizuar kërkesat e parashikuara në Dir⁴ 95/2014/EU për raportimin jofinanciar që ndryshoi Dir 34/2013/EU.

Në zbatim të kërkesës së parashikuar në Dir 95/2014/EU, në 26 qershor të vitit 2017, Komisioni Europian publikon Komunikatën⁵ “Udhëzuesi për raportimin jo-financiar – metodologjia për raportimin e informacionit jo-financiar”.

Ky akt i KE është pjesë e dokumenteve të konsideruara *soft acquis* të cilat duhet të vlerësohen për harmonizim/transpozim nga Institucionet shqiptare. Për këtë arsye, KKK përktheu pa ndryshime nga origjinali tekstin e Komunikatës dhe bëri përshtatjet e duhura me qëllim transpozimin e plotë të këtij dokumenti.

⁴ DIRECTIVE 2014/95/EU OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 22 October 2014 amending Directive 2013/34/EU as regards disclosure of non-financial and diversity information by certain large undertakings and groups

⁵ Brussels, 26.6.2017 C (2017) 4234 final
COMMUNICATION FROM THE COMMISSION Guidelines on non-financial reporting (methodology for reporting non-financial information)

Ky udhëzues u miratua në mbledhjen e muajit qershor. Në faqen zyrtare të internetit të KKK-së, në linkun <http://www.kkk.gov.al/faqe.php?id=4&l2=162&gj=sh>. Publikimi i këtij dokumenti do të ndihmojë njësitet ekonomike, që kanë detyrimin të përgatisin këtë raport, të qartësojnë gjerësinë dhe thellësinë e informacionit të dhënë në këtë raport.

e) Rekomandimi për cilësinë e raportit të drejtimit të brendshëm. Me qëllim harmonizimin e mëtejshëm të kërkesave të Direktivës, Rekomandimi i KE, i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i përshtatur përsa i përket referencave ligjore, është publikuar me emërtimin “Rekomandim mbi cilësinë e raportit të drejtimit të brendshëm të njësive ekonomike për kodin e drejtimit të brendshëm ‘pajtueshmëri ose shpjegim’, Dhjetor 2020. Hartimi i këtij udhëzimi buron nga kërkesa e nenit 19 të ligjit për kontabilitetin ku parashikohet që njësitet ekonomike me interes publik duhet të përfshijnë në raportin e ecuresë së veprimtarisë edhe raportin e drejtimit të brendshëm. Ky nen ka harmonizuar kërkesat e parashikuara në Dir⁶ 95/2014/EU për raportimin jofinanciar që ndryshoi Dir 34/2013/EU. Për plotësimin korrekt të këtij raporti, KE publikoi në 9 prill 2014 një rekomandim mbi cilësinë e raportit të drejtimit të brendshëm (*RECOMMENDATIONS COMMISSION RECOMMENDATION of 9 April 2014 on the quality of corporate governance reporting (‘comply or explain’) (Text with EEA relevance) (2014/208/EU)*). Ky rekomandim është publikuar në faqen zyrtare të internetit të KKK-së në linkun:

http://kkk.gov.al/foto/uploads/File/Rekomandim%20per%20cilesine%20e%20raportit%20te%20drejtimit%20te%20brendshem_publicuar.pdf

f) Lista e kontrollit. U përgatit lista e kontrollit në formatin e një dokumenti “hartë” për lehtësimin e procesit të përgatitjes së pasqyrave financiare nga njësitet ekonomike të mesme dhe të vogla. Dokumenti i draftuar është miratuar në parim në mbledhjen e muajit dhjetor dhe do të shpërndahet për komente tek përfaqësues të palëve të interesit. Metodologjia e ndërtimit të këtij dokumenti “hartë” ishte krijimi i një matrice që kombinon rreshtin përkatës të pasqyrës së pozicionit financiar me numrat e paragrafëve përkatës të SKK-ve për njohjen, matjen dhe paraqitjen e secilit prej zërave të pasqyrës. Dokumenti pas komenteve nga palët e interesit do të

⁶ DIRECTIVE 2014/95/EU OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 22 October 2014 amending Directive 2013/34/EU as regards disclosure of non-financial and diversity information by certain large undertakings and groups

publikohet në faqen zyrtare të KKK- së në pritje të komenteve nga publiku i gjerë, hartues-auditues-përdorues të pasqyrave financiare me synimin që të publikohet për përdorim brenda vitit 2021.



3.3 *Hartimi i akteve të tjera në zbatim të VKM 505, datë 17.07.2019* *“Për organizimin dhe funksionimin e KKK-së”*

